



**REPUBLIKA E KOSOVËS/  
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI**

---

**CP.nr.274/14**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, gjykatësi Agron J. Hoxhaj, sek. juridike T. Kabashi, në çështjen juridike të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditores së përmbarimit, Dogana e Kosovës me seli në ..., të cilën me autorizim e përfaqëson, N.K nga ..., Divizioni për Përfaqësim Gjyqësor kundër debitorit të përmbarimit, “...” Sh.p.k. me pronar H.G, nga ..., rr.”...”, për përmbarimin e dokumentit të përmbarimit – aktvendimeve me nr. 226 i dt. 07.03.2012, nr. 134 i dt. 07.02.2013, nr. 235 i dt. 07.03.2013 dhe nr. 340 i dt. 23.04.2013, për shkak borxhit doganor në shumë të përgjithshme prej 289.200,00 eurove, dhe i lejuar me aktvendimin e kësaj gjykate, CP.nr.274/14, të dt.02.04.2014, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar në afatin ligjor nga ana e debitorit, në seancën jashtëgjyqësore, me dt.10.11.2014, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. **APROVOHET** pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorës së përmbarimit, “...” SH.P.K – Rr. “...”, nr. ..., si person juridik, me pronar H.G, i ushtruar kundër aktvendimit të kësaj gjykate CP.nr.274/14, të datës 02.04.2014 me të cilën është lejuar propozimi për përmbarim i kreditores, Dogana e Kosovës – ..., vetëm lidhur me ndalimin e mjeteve të cilat i posedon pronari si person fizik si dhe vetëm me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen publike të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të cilat gjinden në banesën e debitorit të cilat janë pronë private e personit fizik dhe nuk janë të regjistruara si pronë e personit juridik.

II. Mbetet në fuqi pjesa tjetër e aktvendimit të kësaj gjykate CP.nr.274/14, të dt.02.04.2014 e me të cilin është lejuar përmbarimi, sa i përket personit juridik.

III. Ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi nga debitori i përmbarimit, nuk e ndalon procedurën përmbarimore.

**A r s y e t i m**

Kreditorja e përmbarimit, Dogana e Kosovës - ..., me datë 11.02.2014, pranë kësaj gjykate, ka bërë propozimin për përmbarim lidhur me aktvendimet administrative, nr. 226 i dt. 07.03.2012, nr. 134 i dt. 07.02.2013, nr. 235 i dt. 07.03.2013 dhe nr. 340 i dt. 23.04.2013, për pagimin e borxhit të papaguar doganor në shumën prej 289.200,00 eurove dhe se kjo gjykatë me Aktvendimin e saj CP.nr.274/14, të dt.02.04.2014, ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditorja e përmbarimit. Kundër aktvendimit të lejimit të propozimit për përmbarim CP.nr.274/14, të dt.02.04.2014, debitori i përmbarimit, në afatin ligjor ka ushtruar prapësim përmes të cilës e kundërshton aktvendimin për lejim, me propozimin që gjykata të aprovojë

prapësimin e ushtruar nga debitori dhe të anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra nga ana e gjykatës lidhur me këtë lëndë. Po ashtu debitori i përmbarimit me datë 30.10.2014 pranë kësaj gjykate ka parashtruar parashtrësë përmes të cilës ka bërë plotësimin e kundërshtimit që e ka paraqitur me dt.20.10.2014, ku ka kërkuar që të shfuqizohet –hjeket nga fuqia Aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit të propozuar, CP.nr.274/14, të dt.02.04.2014.

Kreditorja e përmbarimit, Dogana e Kosovës - ..., me datë 27.10.2014 ka parashtruar përgjigje në prapësim me propozim që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi aktvendimi për lejim CP.nr.274/14, të dt.02.04.2014. Kjo gjykatë pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe nga arsyetimet e dhëna si në prapësimin e ushtruar nga debitori i përmbarimit e po ashtu edhe nga përgjigjeje në prapësim të kreditorit e konstatoje se prapësimin e debitorit do ta aprovojë pjesërisht si të bazuar më konkretisht në kërkesën e debitorit vetëm lidhur me ndalimin e mjeteve të cilat i posedon pronari si person fizik si dhe vetëm me regjistrimin , konfiskimin dhe shitjen publike të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të cilat gjinden në banesën e debitorit të cilat janë pronë private e personit fizik dhe nuk janë të regjistruara si pronë e personit juridik, si person fizik. Për shkaqet e prapësimit kundër një aktvendimi për lejimin e përmbarimit, sin ë rastin konkret, bëhet fjalë në nenin 71 të LPP-së në të cilin, thuhet: *'' Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: ..... kërkesa nga dokumenti përmbarues është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve.....''* . Në rastin konkret me Ligjin për Shoqëritë Tregtare parashihet përgjegjësia e pronarit dhe e personit juridik me përgjegjësi të kufizuar dhe se për këtë arsye në nenin 80 parag. 2 të Ligjit për shoqëritë Tregtare e në të cilin thuhet: *''Një pronar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar nuk është përgjegjës për borxhet ose detyrimet e shoqërisë vetëm për arsye se është pronar''* derisa për përgjegjësinë e personit juridike të kësaj natyre flitet në nenin 80 parag. 1. të Ligjit Për Shoqëritë Tregtare dhe ky aty përcaktohet qartë, se : *''Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është përgjegjëse për të gjitha borxhet e saj dhe detyrimet tjera me tërë asetet''*. Andaj për këto arsye, kjo gjykatë vlerësoj se në rastin konkret, duhet do të aprovojë pjesërisht si i bazuar prapësimi i palës debitore si person fizik derisa pjesa tjetër e aktvendimit të kësaj CP.nr.274/14 të dt.2.4.2014 me të cilin është lejuar propozimi për përmbarim në këtë çështje juridike për palën debitore si person juridike, duhet të mbetet në fuqi, pra që kjo gjykatë e aprovoj pjesërisht si të bazuar prapësimin e pronarës së debitorës së përmbarimit, *''...''* SH.P.K, pra H.G nga Prizreni, si person fizik derisa ekziston përgjegjësia për borxhin e debitorës së përmbarimit, si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, dhe si subjekt juridik kundrejt kreditorës së përmbarimit, Dogana e Kosovës me seli në ....

Ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, në bazë të nenit 77 të LPP-së, nuk e ndalon procedurën e përmbarimit në këtë çështje juridike të përmbarimit.

Prandaj nga ajo u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 3, 21, 22 par. 1 pika 2, 24 par. 2 dhe 3, 27, 36, 38, 67, 71 dhe nenit 73 të LPP-së, lidhur me nenin 80 par. 1 dhe 2 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare si dhe neni 20 i ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**CP.nr.274/14, dt.10.11.2014**

**Sek. juridike,**  
**T. Kabashi**

**G j y k a t ë s i**  
**Agron J. Hoxhaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në ..., në afat prej 7 (shtatë) ditëve pas ditës së pranimi të këtij aktvendimi, e nëpërmjet kësaj gjykate.